



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-054/02-59427/20, më _____

11. 03. 2020

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

U R D H Ë R E S Ë

- I. URDHËROHEN të gjitha drejtoritë e Komunës së Prishtinës që të pezullojnë takimet me palë, përveç takimeve që konsiderohen që janë të natyrës urgjente.
- II. URDHËROHEN drejtoritë përkatëse që të mos lëshojnë leje apo pëlqime për tubime, evenimente kulturore apo promovime në sheshet e kryeqytetit, ku pritet pjesëmarrja e më shumë se 50 personave në këto aktivitete.
- III. URDHËROHET Drejtoria e Shërbimeve Publike që të bëjë dezinfektimin e hapësirave të sporteve në Komunën e Prishtinës.
- IV. Komuna e Prishtinës vazhdon me ofrimin e të gjitha shërbimeve komunale.
- V. Kjo urdhëresë ka për qëllim marrjen e masave parandaluese rreth virusit COVID - 19.
- VI. Kjo urdhëresë hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj.

I DORËZOHET:

- Drejtorive të Komunës së Prishtinës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

